



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr 108 Datë 31.10.08

PËR

miratimin e fondit prej 100 000 lekë për zhvillimin e Krosit Ndërkombëtar që do të zhvillohet në Korçë në 26 tetor 2008

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatoret "Për miratimin e fondit prej 100 000 lekë për zhvillimin e Krosit Ndërkombëtar që do të zhvillohet në Korçë në 26 tetor 2008", Ne zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjit nr 8399 dt. 09.09.2008 "Për buxhetin lokal", Ligjit nr 9836 dt. 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008", Udhëzimit nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008", Udhëzimit nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008", si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit total prej 100 000 lekë për organizimin e krosit Ndërkombëtar që do të zhvillohet në 26.10.2008
2. Ky fond do të perballohet me shumën prej 100 000 lekësh nga fondi rezerve i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00	04980	05	Art	6090000	- 100.000
Shtohet	00	01100	05	Art	6020000	+ 100.000

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatoret.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Raimonda NASE
Raimonda NASE